



PROJEKT - DIPLOMA

Udhëheqja e diplomës

Udhëheqja e temës së diplomës në DIBM-FGJM kryhet nga Stafi Akademik i Brendshëm apo i Ftuar. Diplomanti zgjedh një Udhëheqës në Departament ose jashtë tij i cili miratohet nga Përgjegjësi i Departamentit. Udhëheqësi dhe Studenti janë përgjegjës për ecurinë dhe mbarëvajtjen e temës dhe procesit të diplomimit. Kriteret që duhet të përmbushë Udhëheqësi i diplomës vendosen nga DIBM. Udhëheqësi duhet të shprehë pëlqimin me shkrim për udhëheqjen e temës së diplomës.

- Udhëheqësi i temës së diplomës përgatit programin e punës së diplomantit, duke vendosur edhe afatet e përafërta të përfundimit të çdo pike të programit. Studenti duhet të respektojë afatet e vendosura për të bërë të mundur mbrojtjen me sukses të temës në sesionin normal të mbrojtjes së diplomës;
- Udhëheqësi përcakton grafikun e konsultimeve të programuara me studentin, përgjatë të cilit konsultohet dhe kontrollohet puna e bërë sipas programit të miratuar. Grafiku i konsultimeve është i detyrueshëm të zbatohet nga studentit;
- Para mbrojtjes së tezës së diplomës, udhëheqësi rishikon dhe miraton punimin e kryer nga studentit. Ai jep mendimin e tij me shkrim, ku deklarohet realizimi i programit të punës të tezës së diplomës, niveli cilësor, elementët e punës krijuese të studentit dhe lejimi i mbrojtjes së punimit.

Përmbajtja e kontrolleve

Kontrolli i parë (Regjistrimi dhe Miratimi ne Departament)

- Strukturën Paraprake të Temës së Diplomës;
- Literaturën (titujt);
- Materialet në versionin fillestar të tyre.

Kontrolli i dytë

- Ecurine ne strukturen e Temes se diplomes
- Punen praktike te kryer
- Literaturen

Kontrolli i tretë

- Strukturën Përfundimtare të Temës së Diplomës;
- Literaturën e plotë;
- Materialet e plotë.

Mbrojtja dhe vlerësimi i diplomës

Të gjitha tezat e diplomave, para se të lejohen për mbrojtje, miratohen nga Dekani i Fakultetit. Punimi i diplomës mbrohet para një komisioni të posaçëm, të përbërë nga staf akademik i FGJM si dhe profesionistë të fushës së inxhinierisë së minierave dhe markshajderisë, i propozuar nga DIBM dhe i miratuar nga Dekani. Mbrojtja e diplomës është publike. Komisioni i mbrojtjes së diplomave përbëhet nga 5 anëtarë. Komisioni

DEPARTAMENTI I INXHINIERISE SE BURIMEVE MINERARE



funksionon kur janë prezent jo më pak se 2/3 e anëtarëve të tij. Secili nga anëtarët ka në dispozicion një vlerësim nga 0-100 pike. Rezultati përfundimtar i diplomës përlllogaritet në bazë të mesatares aritmetike të vlerësimit të të gjithë anëtarëve. Vlerësimi me notë bëhet sipas pikëzimit:

100 - 95	pikë vlerësohet me notë përfundimtare	10 (dhjetë)
94 - 85	pikë vlerësohet me notë përfundimtare	9 (nëntë)
84 - 75	pikë vlerësohet me notë përfundimtare	8 (tetë)
74 - 65	pikë vlerësohet me notë përfundimtare	7 (shtatë)
64 - 55	pikë vlerësohet me notë përfundimtare	6 (gjashtë)
54 - 45	pikë vlerësohet me notë përfundimtare	5 (pesë)
nën 44	pikë vlerësohet me notë negative	4 (katër)

Nota regjistrohet në procesverbalin e mbrojtjes së diplomave. Procesverbali firmoset nga të gjithë anëtarët e komisionit. Në përfundim të çdo seance mbrojtjeje, në mënyrë publike kryetari i komisionit, në prani të anëtarëve, i komunikon çdo diplomanti notën, me të cilën është vlerësuar punimi i tij. Në rast se studenti vlerësohet me notë negative në mbrojtjen që i bën tezës së tij, ai mund të mbrojë përsëri të njëjtën tezë ose të mbrojë një tezë të re brenda një periudhe jo më parë se një vit dhe jo më vonë se tre vjet. Gjatë periudhës tre vjeçare nga koha e përfundimit të studimeve të plota, diplomanti ka të drejtë të mbrojë tezën e tij deri në dy herë. Nëse në të dy rastet diplomanti është vlerësuar nga komisioni me notë negative ose ai nuk paraqitet për të bërë mbrojtjen e punimit brenda afateve maksimale (tre vjeçare), atëherë studenti humb të drejtën e diplomimit.

Modalitete

Studenti nuk mund të mbrojë temën e diplomës pa shlyer më parë të gjitha detyrimet dhe pa fituar 90 kredite të parashikuara në planin mësimor të programit të studimit.

Kriteret e Diplomimit

- Kriteri 1. Shlyerja e tre kontrolleve të diplomës
- Kriteri 2. Vlerësimi pozitiv nga Udhëheqësi
- Kriteri 3. Miratimi nga Dekani i FGJM
- Kriteri 4. Mbrojtja e projekt diplomës përpara komisionit

Studenti, para mbrojtjes së punimit të diplomës, duhet të ketë likuiduar të gjitha detyrimet financiare dhe materiale që mund të ketë me universitetin, bibliotekën shkencore, bibliotekën kombëtare, konviktet, etj.